

SGS Automotive Albania sh.p.k

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

PËRMBAJTJA

	FAQJA
PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO	6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8-38

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe Drejtimit të SGS Automotive Albania Shpk,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të SGS Automotive Albania Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të veçanta paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar e veçantë të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 si dhe performancën e saj financiare të veçantë dhe flukset monetare të veçanta për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare të veçanta në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin 4 - Vlerësimet Kritike të Kontabilitetit dhe Gjykime në Zbatimin e Politikave të Kontabilitetit të pasqyrave financiare, që përshkruan efektet e përfundimit të periudhës së Koncesionit për Shoqërinë. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brëndshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të veçanta.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare të veçanta, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrollleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania Shpk

Deloitte Audit Albania Shpk
Rr. Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji - Miniera,
Tiranë, Shqipëri
Numri i identifikimit unik të subjektit (NUIS): L41709002H



Enida Cara
Auditues Ligjor
Partner Angazhimi

30 Mars, 2020

Tiranë, Shqipëri

SGS Automotive Albania sh.p.k
Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019
(shumat janë të shprehura në LEK)

		Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Aktive jo-materiale	5	180,857	79,217,903
E drejta e përdorimit të aktiveve	6	11,848,532	-
Inventari	7	9,682,077	3,343,457
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	8	8,642,586	4,854,274
Tatim fitimi i parapaguar	17	653,411	-
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	9	531,149,253	473,434,942
Totali i aktiveve afatshkurtra		562,156,716	560,850,576
TOTALI I AKTIVEVE		562,156,716	560,850,576
Kapitali			
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	10	190,000,100	190,000,100
Fitimi pashpërndarë		231,359,122	192,244,244
Total i kapitalit		421,359,222	382,244,344
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Vlera e riinvestimit	13	11,819,069	80,977,361
Detyrime qiraje	14	11,694,225	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	11	112,037,526	84,240,599
Detyrime kontraktore	12	5,246,674	3,848,187
Tatim fitimi i pagueshëm	17	-	9,540,085
Total i detyrimeve afatshkurtra		140,797,494	178,606,232
TOTAL I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		562,156,716	560,850,576

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 deri në 38, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta.

Këto pasqyra financiare u përgatitën nga Menaxhimi i Shoqërisë më 30 Mars, 2020 dhe të firmosura nga:

Z. Alexandros Michail
Administrator



Znj. Mirkela Puriqi
Menaxhere Finance

SGS Automotive Albania sh.p.k**Pasqyra e veçantë e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(shumat janë të shprehura në LEK)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat operative			
Të ardhura nga kontratat me klientët	15	970,401,001	944,982,770
Totali i të ardhurave operative		970,401,001	944,982,770
Shpenzimet operative			
Materiale të përdorura për konsum	16	(16,548,983)	(16,244,228)
Shpenzime personeli	17	(232,481,802)	(212,862,326)
Amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve jo-materiale	5	(76,424,740)	(116,542,660)
Shpenzime amortizimi - e drejta e përdorimit të aktiveve	6	(11,898,985)	-
Shpenzime të tjera operative neto	18	(339,361,987)	(347,837,690)
Totali shpenzimeve		676,716,497	(693,486,904)
Fitimi nga aktiviteti operativ		293,684,504	251,495,866
Shpenzime financiare		89,763	85,391
Fitim/(Humbje) nga kursi i këmbimit	20	(186,594)	672,530
Totali i të ardhurës/(shpenzimeve) financiare neto	19	(96,831)	757,921
Fitimi para tatimit		293,587,673	252,253,787
Tatimi mbi fitimin	21	(62,228,551)	(60,009,543)
Fitimi neto i vitit		231,359,122	192,244,244
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		231,359,122	192,244,244

Pasqyra e veçantë e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 deri në 38, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta.

SGS Automotive Albania sh.p.k.

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në capital neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2019

(shumat janë të shprehura në LEK)

	Kapitali aksionar	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 Janar, 2018	190,000,100	69,473,631	259,473,731
Fitimi i vitit	-	192,244,244	192,244,244
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	192,244,244	192,244,244
Dividentë të paguar	-	(69,473,631)	(69,473,631)
Gjendja më 31 Dhjetor, 2018	190,000,100	192,244,244	382,244,344
Fitimi i vitit	-	231,359,122	231,359,122
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	231,359,122	231,359,122
Dividentë të paguar	-	(192,244,244)	(192,244,244)
Gjendja më 31 Dhjetor, 2019	190,000,100	231,359,122	421,359,222

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 to 38, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta.

SGS Automotive Albania sh.p.k**Pasqyra e veçantë e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2019***(shumat janë të shprehura në LEK)*

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2018
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti operativ:		
Fitimi para tatimit	293,587,673	252,253,786
Rregullime për:		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	76,424,740	116,542,659
Zhvlerësim i të drejtës për përdorimin e aktiveve	11,898,985	-
Humbjet nga shitja e aktiveve	3,504,528	-
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	78,564	-
Ndikimi i vlerës në kohë të ndryshimit të normave të aktualizimit	(89,763)	(85,389)
Ndikimi i rivlerësimit tek detyrimet e qerasë	(372,205)	-
Ndikimi i rivlerësimit tek paraja dhe ekuivalentet e saj	(360,527)	1,025,657
Fitimi nga aktiviteti operativ para ndryshimeve në kapitalin punues	384,671,995	369,736,713
(Rritje)/Rënie në inventarë	(6,338,620)	7,595,886
(Rritje)/Rënie në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	(3,866,876)	2,377,056
Rritje/(Rënie) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	33,990,054	(29,918,631)
Rënie e vlerës së riinvestimit	(69,158,292)	(40,949,743)
Interesi i arkëtuar	89,763	85,389
Tatim fitimi i paguar	(77,216,687)	(52,436,740)
Mjete monetare neto të gjeneruar nga aktivitetet operative	262,171,337	256,489,930
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	(892,224)	(298,742)
Mjete monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese	(892,224)	(298,742)
Flukset e parasë nga aktivitetet e financimit		
Dividendët e paguar	(192,244,244)	(69,473,631)
Ripagimi i Detyrimeve të qirasë	(11,681,085)	
Mjete monetare neto të përdorura në aktivitetet financuese	(203,925,329)	(69,473,631)
Rritja e Mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre	57,353,784	186,717,557
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	473,434,942	287,743,042
Ndikimi i rivlerësimit tek paraja dhe ekuivalentet e saj	360,527	(1,025,656)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	531,149,253	473,434,942

Pasqyra e veçantë e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 to 38 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

SGS Automotive Albania Sh.p.k. ("Shoqëria") është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe e regjistruar më 10 shtator 2009 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Adresa e zyrave qendrore është në Tiranë, Rr. Irfan Tomini, Ndërtesa G & P, Kati i parë, Tiranë.

Shoqëria mëmë është SGS Societe General De Surveillance s.a., Gjenevë, Zvicër, e cila më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 zotëron 100% të kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë lidhet me inspektimin teknik të mjeteve automobilistike për një periudhë 10 vjeçare siç është rënë dakord në kontratën e koncesionit ndërmjet SGS Societe General De Surveillance s.a. dhe Ministrisë së Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë, e cila ka rolin e autoritetit kontraktues. Shoqëria operon në tregun vendas dhe ka hapur 15 pika në të gjithë vendin.

Më 31 Dhjetor 2019, Shoqëria kishte 151 punonjës (31 Dhjetor 2018: 153).

1.1 Kontrata e koncesionit

Përshkrimi i marrëveshjes

Sipas Nenit 100 të Kushtetutës dhe Nenit 21 të Ligjit Shqiptar nr. 9663 "Ligji i Koncesionit" (i ndryshuar) i datës 18 dhjetor 2006, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27 "Mbi aprovimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesionit", i datës 19 janar 2007, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 643 "Mbi zgjedhjen e Autoritetit Kontraktual për dhënien e koncesionit të kontrollit të detyrueshëm teknik për mjetet dhe rimorkiot e tyre në Republikën e Shqipërisë, për (i) projektimin, financimin, rehabilitimin, testimin, përdorimin dhe mbajtjen e qendrave të kontrollit teknik ekzistuese dhe makineritë dhe mjetet ekzistuese përgjatë periudhës së koncesionit; (ii) projektimin, financimin, ndërtimin, testimin, pronësinë, përdorimin dhe transferimin e projektit, Qeveria e Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Punëve Publike të Shqipërisë dhe SGS General De Surveillance s.a që hynë në marrëveshjen e koncesionit më datë 3 shtator 2009 ("Marrëveshja e Koncesionit"). SGS Societe Generale De Surveillance s.a. themloi SGS Automotive Albania sh.p.k. për qëllime të Marrëveshjes së Koncesionit si më poshtë.

Periudha e koncesionit

Koncesioni është dhënë për një periudhë 10 vjeçare duke filluar nga data e hyrjes në fuqi (3 Shtator 2009). Një kontratë shtesë u nënshkrua në 2 Shtator 2019 ku kohëzgjatja e koncesionit u shty deri më 31 Dhjetor 2020.

Autoriteti Kontraktues duhet të njoftojë Koncesionarin 3 (tre) muaj përpara nënshkrimit të ndonjë kontrate / marrëveshje me subjektet e tjera për të ofruar shërbimin e inspektimit të automjeteve.

Objekti i Koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep kompanisë (në rolin dhe në këtë paragraf të quajtur "Operator") të drejtën për:

1. Të projektojë, financojë, rehabilitojë, testojë, të ketë në përdorim, të shfrytëzojë dhe mirëmbajë QKT ekzistuese dhe pajisjet ekzistuese për aq kohë sa do t'i ketë në përdorim;
2. Të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi dhe në fund të periudhës së koncesionit të transferojë, të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë QKT e re dhe pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike.
3. T'i ofrojë klientëve shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në mënyrën e duhur dhe me profesionalizëm, në përputhje me këtë kontratë, manualin e kontrollit të mjeteve dhe ligjin në fuqi.

1. HYRJE (VAZHDIM)

1.1 Kontrata e koncesionit (vazhdim)

Dorëzimi i Mjediseve të Koncesionit dhe Infrastrukturës

Në përfundim të periudhës koncesionare, Operatori do t'i kthejë Autoritetit Kontraktues përdorimin e QKT ekzistuese. Në përfundim të periudhës koncesionare, Operatori do t'i transferojë pa pagesë Autoritetit Kontraktues pronësinë mbi QKT e re, QKTL si dhe mbi të gjitha pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike (si ato të QKT ekzistuese ashtu dhe ato të QKT të re si dhe QKTL) si dhe, në çdo rast, do të kryejë të gjitha ato veprime të cilat janë pazgjidhshmërisht të lidhura me veprimet e transferimit/kalimit të pronësisë dhe të nënshkruajë të gjitha aktet që do të bëjnë të mundur këtë kalim pronësie.

Procesi i dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara mbarimit të periudhës koncesionare pas një inspektimi të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit.

Të drejtat e Operatorit përfshijne:

- Të ushtrojë të gjitha të drejtat në lidhje me përdorimin ekskluziv të sheshit dhe të pajisjeve ekzistuese, dhe të pajisjeve elektromekanike dhe kompjuterike (nga data e instalimit).
- Të punësojë apo angazhojë punonjës me qëllim zbatimin e koncesionit si dhe të hartojë politikën e vet të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë kontratë.
- Të kryejë veprime të tjera që i konsideron të nevojshme për të përmbushur detyrimet dhe të ushtrojë të drejtat e tij sipas kësaj kontrate.
- Të kërkojë zgjatjen e periudhës së koncesionit në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate.

Detyrime të Përgjithshme të Operatorit përfshijne:

- Të zbatojë projektin e koncesionit në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate dhe anekset e saj. Brenda 5 muajve, Operatori duhet të ketë përfunduar rehabilitimin e QKT-ve ekzistuese në përputhje me ligjin.
- Brenda 6 muajve nga pajisja me leje ndërtimi, Operatori duhet të ketë përfunduar së ndërtuari QKT-në e re.
- Të ofrojë dhe të kryejë shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në përputhje me ligjet, manualin e kontrollit të mjeteve, praktikat më të mira të industrisë dhe ofertën e Operatorit dhe të mbajë të pacënuar ofrimin e këtij shërbimi.
- Nga data efektive të zbatojë si orar minimal pune në QKT ekzistuese, QKT e Re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL, orarin e hënë – e premte 09:00-17:00 dhe e shtunë 08:00-13:00. Operatori gjatë këtij orari detyrohet të mbajë funksionale QKT ekzistuese, QKT e re (pas ndërtimit në përputhje me këtë kontratë) dhe QKTL
- Të lejojë autoritetin kontraktues të inspektojë secilën nga QKT ekzistuese, QKT e Re dhe QKTL në çdo kohë të arsyeshme me ose pa njoftim paraprak.
- Të kryejë kontrolle teknike të të gjitha mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre të paraqitura në testim në përputhje me manualin e kontrollit të mjeteve.
- Të mirëmbajë QKT ekzistuese, QKT të Re dhe QKTL, pajisjet ekzistuese dhe pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike deri në momentin e kthimit mbrapsht tek autoriteti kontraktues sipas kushteve të kësaj kontrate në përputhje me praktikat më të mira të industrisë.
- Të përballojë vetë të gjitha kostot dhe shpenzimet e çdo natyre lidhur me largimin dhe transportimin nga sheshi i paisjeve ekzistuese në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktues në përfundim të fazës së ndërtimit.
- Të ruajë të gjitha vërtetimet e papërdorura apo të palëshuara për rezultatet e kontrolleve të kryera në QKT ekzistuese, QKT e re dhe QKTL në një vend të sigurt nën kontrollin e Operatorit dhe në kushte të përshtatshme për t'i ruajtur ato nga dëmtime të çdo lloji si psh mekanike, atmosferike, etj.

1. HYRJE (VAZHDIM)

1.1 Marrëveshja e Koncesionit (vazhduar)

Detyrime të Përgjithshme të Operatorit (vazhdim)

- T'i paraqesë autoritetit kontraktues në kohë të përshtatshme sapo t'i kërkohet prej tij informacion apo çdo dokument të kërkuar që ka të bëjë me funksionimin e QKT ekzistuese, QKT e re dhe QKTL si dhe të shërbimit.
- Të shoqërojë çdo pagesë të tarifës koncesionare me një raport dhe dokumenta të nevojshëm plotësues mbi xhiron e realizuar nga tarifat e kontrollit dhe tarifat e rikontrollit për periudhën për të cilën pagesa e tarifës koncesionare kryhet.
- Të krijojë një bazë të dhënash elektronike të re dhe bashkëkohore dhe ta përditësojë atë periodikisht. Specifikimet teknike për realizimin e këtij procesi do të përcaktohen nga ana e stafit teknik përkatës të të dy palëve.
- Në fund të periudhës koncesionare të transferojë tek autoriteti kontraktues pronësinë mbi QKT e re, QKTL, linjat e kontrollit dhe pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike në gjendje funksionale, përjashtuar amortizimin normal, ashtu siç do të jenë pas kryerjes së riinvestimit.
- Të mos kryejë shërbimin ndaj mjeteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet fiskale që lidhen me përdorimin e mjeteve të tilla si: taksa vjetore e qarkullimit rrugor, taksa vjetore e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe gjobat për mosparaqitjen brenda afateve për kryerjen e shërbimit në qendrat e kontrollit teknik.
- Brenda muajit të parë të vitit të 7-të kalendarik të periudhës koncesionare, Operatori duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktues, kalendarin e punimeve të riinvestimit, ku të jenë përcaktuar afatet e riinvestimit dhe vlerat përkatëse sipas zërave.

Tarifat e koncesionit

Operatori detyrohet t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesioni të barabartë më 5% (pesë përqind) të xhiros vjetore (para tatim fitimit). Tarifa e koncesionit do të përlogaritet dhe paguhet çdo muaj duke filluar nga data efektive.

Investimet e Operatorit

Operatori duhet të beje nje investim ne menyre qe te mundesoje ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove te tyre sipas kësaj kontrate. Ky investim do të jetë 561,003,000 Lekë, nga të cilat 267,402,000 Lekë do të destinohen për pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike.

Riinvestimet e Operatorit

Operatori do të investojë me qëllim mirëmbajtjen e aktiveve afatgjata objekt të Koncesionit shumen prej 172,000,000 Lekë që përfaqëson 30.7% të investimit të Operatorit.

Kjo sasi do të riinvestohet brenda tre viteve të fundit të Periudhës së Koncesionit. Vlera e riinvestimit mbetet një kusht i panegociueshëm i Marrëveshjes dhe si i tillë, nuk mund të ndryshohet.

Në rast se kater muaj para përfundimit të periudhës koncesionare Operatori nuk ka kryer plotësisht apo pjesërisht riinvestimin detyrohet:

- a) t'i paguajë menjëherë Autoritetit Kontraktues diferencën e vlerës së riinvestimit të pakryer mbi 56,100,300 Lekë kur vlera e riinvestimit të pakryer është më e madhe se kjo shumë, ndërsa pjesa e mbetur paguhet ditën e fundit të periudhës koncesionare;
- b) t'i paguajë Autoritetit Kontraktues vlerën e riinvestimit të mbetur, nëse ka të tillë, në ditën e fundit të periudhës koncesionare, kur vlera e riinvestimit të pakryer është më e vogël se 56,100,300 Lekë

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të vecanta janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të). Ky është grupi i parë i pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë, në të cilat SNRF 16 “Qiratë” është aplikuar. Ndryshimet në politikat e rëndësishme të kontabilitetit përshkruhen në Shënimin 3.

2.2 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe janë të paraqitura në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Në vijim të informacionit të shpalosur në Shënimin 1.1 të këtyre pasqyrave financiare, aktivet rivlerësohen për të pasqyruar shumën e rikuperueshme dhe detyrimet e tyre për detyrimet që mund të lindin gjatë skadimit të marrëveshjes së koncesionit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.13 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit njihen në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetarë konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit, përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë janë si vijim:

	31 Dhjetor, 2019	31 Dhjetor, 2018
LEK / USD	108.64	107.82
LEK / EUR	121.77	123.42

3.2 Aktivet afatgjata jo materiale

Marrëveshje për shërbime koncesionare

Shoqëria njih një aktiv afatgjatë jo-material nga një marrëveshje koncesionare në momentin kur ka të drejtën për të tarifuar për përdorimin e infrastrukturës së koncesionit. Aktivet afatgjata jo-materiale maten fillimisht me kosto, e cila është vlera e drejtë e paguar për të ofruar shërbimet e marrëveshjes koncesionare. Pas njohjes fillestare aktivet afatgjata jo-materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shoqëria ka aplikuar interpretimin 12 të Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për Raportimin Financiar (referuar si “KIRFN 12”) “*Marrëveshjet për Shërbimet Koncesionare*” dhe, 1 “*Ndryshime në Pasivët Ekzistues të Nxjerrjes nga Përdorimi, Ristrukturimi dhe Pasive të Ngjashme*”. Interpretimi është zbatuar për herë të parë në përgatitjen e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011 në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (referuar si “SNK”) 8 Politikat Kontabël. Aktiv i afatgjatë jo-material përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për të tarifuar përdoruesit për shërbimin publik (Shënim 5).

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Aktivet afatgjata jo-materiale (vazhdim)

Shpërblime jo-monetare (Qendra e Kontrollit Teknik dhe pajisje të lidhura me të)

E drejta për të ofruar shërbime koncesionare në këmbim të përdorimit të Qendrave të Kontrollit Teknik ("QKT"), njihet në koston e investimit për projektim, financim, rehabilitim, testim, mirëmbajtje dhe përdorim të QKT-ve ekzistuese dhe pajisjeve të lidhura me të, e cila konsiderohet si vlera e drejtë.

Vlera e riinvestimit në 3 vitet e fundit të aktivitetit, paraqet një përmirësim të detyrueshëm të infrastrukturës së koncesionit të shërbimit (zëvendëson infrastrukturën origjinale të programeve dhe pajisjeve kompjuterike) i cili rrit jetën e aktivitetit. Shpenzimet e përmirësimit (të aktualizuara me vlerën aktuale me një normë para tatimit që paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasasë dhe rreziqet për detyrimin specifik) matet si një aktiv afatgjatë jo-material dhe njihet në fillim të periudhës së koncesionit.

Shpenzimet vijuese

Shpenzimet vijuese kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të përfshirë specifikisht në aktivin të cilit i përkasin. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në pasqyrat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (në fitim ose humbje) kur ndodhin.

Amortizimi

Jeta e dobishme e vlerës së mbetur të aktivitetit afatgjatë jo-material që i përket marrëveshjes së shërbimit koncesionar është periudha që kur është në dispozicion për përdorim deri në fund të periudhës së koncesionit, 31 Dhjetor 2020.

4.3 Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë e dispozitave kontraktuale mbi instrumentin.

Instrumentet financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohej më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktivitet financiarë – klasifikimi dhe matja e mepasme – kategoritë e matjes. Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA (sipas paragrafit më lart). Klasifikimi dhe matja e mepasme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivitetit.

Aktivitet financiarë – klasifikimi dhe matja e mepasme – modeli i biznesit. Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale ("mbajtja për mbledhje të flukseve monetare") ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve ("mbajtja për mbledhje të flukseve monetare dhe shitje") ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit "të tjera" dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare individuale (në nivel individual) bazuar në të gjithë evidencën përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin individual në dispozicion në datën e vlerësimit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Instrumentet financiare (vazhdim)

Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivitetet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxherët.

Për kalimin në SNRF 9, Shoqëria identifikoi se:

- Rreziqet kryesore të modelit të biznesit janë në përputhje me modelin “mbaj për të mbledhur”, me fokus në rrezikun e kredisë. Asnjë peshë nuk i jepet riskut të çmimit ose vlerës së drejtë;
- Deri tani nuk ka pasur asnjë shitje. Shitjet do të ndodhin vetëm në përgjigje të përkeqësimit të riskut të kredisë, që rezulton nga shkeljet e kriterëve të brendshme të riskut të kredisë. Këto shitje do të ishin në përputhje me një model biznesi “mbaj për të mbledhur”. Një shitje për shkak të plotësimit të nevojave të likuiditetit do të ishte rastësore.

Prandaj, modeli i biznesit që lidhet me Llogaritë e arkëtueshme dhe te tjera konsiderohet të jetë “mbaj për të mbledhur”.

Aktivitetet financiare – klasifikimi dhe matja e mepasme – karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare.

Kur modeli i biznesit ka si objekt mbajtjen e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për riskun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj riskut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktiviteti financiar klasifikohet dhe matet me VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktiviteti dhe nuk rivlerësohet më pas.

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktiviteti financiar janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit kërkon gjykim. Llogaritë e arkëtueshme dhe te tjera të Shoqërisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e SNRF 15, që konsiderohet të jetë principal. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

Matja e humbjes së pritshme të kredisë. Zbritjet për humbjet e pritshme të kredisë llogariten për llogaritë e arkëtueshme dhe te tjera të matura me koston e amortizuar. Meqenëse llogaritë e arkëtueshme nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, vlera e humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës së këtyre aktiveve. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionimi në të cilën llogariten kostot e humbjeve për llogaritë e arkëtueshme që i perkasin periudhave të ndryshme të maturimit ose vonësës. SNRF 9 shpjegon përdorimin e këtyre matricave të provizionimit në shembujt ilustrues, por nuk specifikon se si duhet të përcaktohen normat në praktikë. Megjithatë, është e qartë se normat e dhëna, dhe rrjedhimisht llogaritja e humbjeve si një përqindje e balancës, duhet të rritet për periudhat më të gjata të vonësës.

Shoqëria ka zbatuar matricën e provizionimit për llogaritjen e humbjeve të pritshme të kredisë për llogaritë të arkëtueshme sipas kategorive të ndryshme të maturimit:

Vjetërsia	0-60	61-90	91-120	121-180	181-240	241-300	301-360	>360
% e zhvlerësimit	0%	0.5%	15%	30%	50%	75%	100%	100%

Këto norma të mosshlyerjes marrin në konsideratë informacionin për periudhat e ardhshme bazuar në raportin e borxhit të keq.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Instrumentet financiare (vazhdim)

Aktivitetet financiare – fshirja. Aktivitetet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer cdo përpjekje për rimarrjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit. Treguesit që nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mosshlyerjes, paafësi paguese dhe falimentim. Shoqëria mund të fshijë aktivitetet financiare që janë subjekt i zbetimit me force të marreveshjes kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për marrjen e tyre.

Aktivitetet financiare – çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivitetet financiare kur (a) aktivitetet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet përfundojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivitetet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura me KA.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

Netimi i instrumenteve financiare. Aktivitetet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë netimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospaguese dhe (iii) në rast të paafësisë paguese ose falimentimit.

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogaritë e arkëtueshme dhe te tjera, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, dhe llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Shoqërisë maten si vijon.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre mbahen me KA sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare kontraktuale reflektojnë VPPI (ii) dhe nuk janë të dizenuara me VDNFH.

Llogaritë e arkëtueshme dhe te tjera. Llogaritë e arkëtueshme janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdim mbahen me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e alokimit të të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël neto. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat e ardhshme të parasë ose arketimet (duke përfshirë humbjet e pritshme të kredise) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël bruto të instrumentit financiar.

Llogari të pagueshme dhe te tjera. Llogaritë e pagueshme dhe te tjera njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj të performancës sipas kontratës dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas mbahet me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Të ardhurat

Të ardhurat janë fitime të gjeneruara gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë. Të ardhurat njihen për shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumën e mbledhura në emër të palëve të treta.

Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

Shoqëria siguron shërbime me kontrata me çmim fiks. Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet ofrohen. Për kontratat me çmim fiks, të ardhurat njihen në bazë të shërbimit të dhënë në fund të periudhës raportuese, në raport me shërbimet totale që do të ofrohen, pasi klienti i merr dhe i përdor përfitimet njëkohësisht.

Shoqëria nuk pret të ketë kontrata ku periudha midis transferimit të shërbimit të klientit dhe pagesës nga ky i fundit të kalojë një vit. Për pasojë, Shoqëria nuk rregullon asnjë çmim transaksioni për vlerën në kohë të parasë.

Të ardhura nga interesat

Të ardhurat nga interesat përlllogariten në bazë kohore, duke iu referuar principalit të papaguar dhe normës së interesit efektiv.

3.5 Kapitali I paguar

Kapitali aksionar përbëhet nga kontributet në para të themeluesve të Shoqërisë. Kapitali aksionar mbahet në monedhën vendase Lekë, i konvertuar nga monedha e huaj, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

3.6 Përfitimet e punonjësve

Pagat, kontributet shoqërore, leja vjetore e paguar, ditët me raport mjekësor të paguar dhe bonuset përlllogariten në vitin në të cilin shërbimet përkatëse kryhen nga punonjësit e Shoqërisë. Kostot e kryera në emër të Shoqërisë janë të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes në momentin që ndodhin. Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar kontribute të mëtejshme për pensione apo të ngjashme.

3.7 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyrë

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen e vitit, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% e fitimit të tatueshëm (2018; 15%).

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato rimerren, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet nëse është e mundshme që fitime të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme.

Aktivitet tatimor të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Sipas pasigurive të lidhura me realizimin e aktivitet tatimor të shtyrë (të cilat vijnë nga diferencat e përkohshme të aktiveve për të cilat baza tatimore është më e madhe se vlera kontabël) të lidhura edhe me kohëzgjatjen e kontratës së koncesionit, Shoqëria nuk ka njohur aktiv tatimor të shtyrë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2019.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Provizione

Provizionet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Nëse efekti është material, provizionet njihen duke skontuar flukset e ardhme të parasë me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është me e mundshme që një dalje burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit provizionet rimerren. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provizion për humbjet e ardhshme operative.

3.9 Angazhimet, aktivet dhe detyrimet e kushtezuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një detyrim të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivet e kushtëzuara krijohen zakonisht nga ngjarje të paplanifikuara ose të papritura të cilat krijojnë mundësinë e flukseve hyrëse në Shoqëri. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyra financiare, pasi kjo do të krijonte njohjen e një të ardhure e cila mund të mos realizohet kurrë. Sidoqoftë, kur realizimi i të ardhurave është i sigurt, atëherë aktivi përkatës nuk është më i kushtëzuar dhe njohja e tij është e përshtatshme. Aktivet e kushtëzuara vlerësohen vazhdimisht për t'u siguruar se zhvillimet reflektohen në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Nëse është krijuar siguria se do të ketë një hyrje të përfitimeve ekonomike, atëherë aktiviteti dhe e ardhura përkatëse do të njihen në pasqyrat financiare të periudhës kur ndryshimi ndodh.

3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtorët e Shoqërisë, së bashku me entitetet që kontrollojnë, që kanë një ndikim të rëndësishëm mbi veprimtaritë dhe drejtimin e Shoqërisë. Në marrjen në konsideratë të çdo marrëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmendja i drejtohet thelbit të marrëdhënies, jo vetëm formës ligjore.

3.11 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin financiar të Shoqërisë në datën e raportimit (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së raportimit që nuk janë ngjarje rregulluese janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare nëse janë materiale.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.12 Standardet dhe interpretimet efektive gjatë periudhës

- ***Zbatimi i SNRF 9 “Instrumentet Financiare”***

Shoqëria ka zbatuar SNRF 9, Instrumentet Financiare, nga 1 Janari 2019. Shoqëria ka zgjedhur të mos riparaqese shumat krahasuese dhe të njohë çdo rregullim të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare në balancën fillestare të fitimeve të akumuluar në datën e zbatimit fillestar të standardeve, 1 janar 2019. Rrjedhimisht, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentet Financiare: Shënimet shpjeguese, janë zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Dhënia e informacioneve shpjeguese për periudhën krahasuese përsërit shënimet shpjeguese të bëra në vitin paraprak.

Të gjitha kategoritë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre janë riklasifikuar nga kategoria e matjes hua dhe të arkëtueshme (H&A), sipas SNK 39 te kategoria e matjes me kosto të amortizuar, sipas SNRF 9, në ditën kur ka filluar zbatimi i standardit. Humbja e pritshme të kreditit për balancat e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre janë të papërfillshme.

- ***Zbatimi i SNRF 15 “Të ardhurat nga kontratat me klientët”***

Shoqëria ka zbatuar metodën retrospektive me efektin e akumuluar të zbatimit fillestar, të njohur në fitime të akumuluar, në datën e zbatimit fillestar të SNRF 15. Shoqëria ka zgjedhur të zbatojë lehtësitë praktike të vlefshme për këto metoda të kalimit dhe zbaton SNRF 15 vetëm për kontratat që nuk janë përfunduar në datën e aplikimit fillestar (1 janar 2018).

- **Ndryshimet në SNRF 2 “Pagesat bazuar në Aksione”,** - Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave me bazë aksionet (efektiv më ose pas datës 1 janar 2018),
- **Ndryshimet në SNRF 4 “Kontratat e sigurimit”** - Aplikimi i SNRF 9 “Instrumentat financiarë” me SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, ose kur SNRF 9 “Instrumentat financiarë”, është aplikuar për herë të parë),
- **Ndryshimet në SNK 40 “Aktivet Materiale Afatgjata të Investuara”** - Transferimet e aktiveve materiale afatgjata të investuara (efektive më ose pas 1 janarit 2018),
- **Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28 si pasojë e “Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)”** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 12, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 1 dhe SNK 28 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2018).
- **IFRIC 22 “Transaksionet në valutë dhe Konsiderata për Avancat”** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.13 Miratimi i Standardeve dhe Interpretimeve të Reja ose të Rishikuara

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Shoqëria ka aplikuar SNRF 16 – Qirate për herë të parë nga 1 janari 2019. Një numër standardesh të tjera të reja janë gjithashtu efektive nga 1 janari 2019, por ato nuk kanë një efekt material në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

Kompania aplikoi SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, sipas së cilës efekti kumulativ i aplikimit fillestar njihet në fitimin e pashpërndarë në 1 Janar 2019. Prandaj, informacioni krahasues i paraqitur për vitin 2018 nuk është riparaqitur - d.m.th. ai paraqitet, siç u raportua më parë, nën SNK 17 dhe interpretimet e ndërlidhura. Detajet e ndryshimeve në politikat e kontabilitetit janë shpalosur më poshtë. Për më tepër, kërkesat e zbulimit në SNRF 16 nuk janë zbatuar në përgjithësi për informacionin krahasues.

A. Përcaktimi i qirasë

Me parë, Shoqëria përcaktonte në fillim të kontratës nëse një marrëveshje ishte ose përmbante një qira nën KIRFN 4 - Përcaktimi nëse një Marrëveshje është marrëveshje Qiraje. Kompania tani vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira bazuar në përkufizimin e qirasë, siç shpjegohet më poshtë. Qiraja është një kontratë ose pjesë e një kontrate, e cila i jep të drejtën e përdorimit të një aktivi (të aktivi bazë) për një periudhë kohore në këmbim të një shume.

Shoqëria zbatoi SNRF 16 vetëm për kontratat që më parë ishin identifikuar si qiratë. Kontratat të cilat nuk ishin identifikuar si qiranë sipas SNK 17 dhe KIRFN 4 nuk u rivlerësuan nëse ekziston një qira sipas SNRF 16. Prandaj, përkufizimi i qirasë sipas SNRF 16 u zbatua vetëm për kontratat e lidhura ose ndryshuar në ose pas 1 janarit 2019.

B. Si qiramarrës

Si qiramarrës, Shoqëria merr me qira ambiente zyre, magazina dhe automjete. Shoqëria më parë ka klasifikuar qiratë si qira operative ose financiare bazuar në vlerësimin e saj nëse qiraja transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e rastësishme në pronësi të aktivitetit themelor në kompani. Sipas SNRF 16, Shoqëria njih të drejtën për përdorimin e aktiveve dhe detyrimet e qiradhënies për shumicën e këtyre qirave - d.m.th. këto qira janë pjesë e bilancit.

Me fillimin ose me modifikimin e një kontrate që përmban një komponent të qirasë, Shoqëria shpërndan vlerësimin në kontratë për secilin përbërës të qirasë në bazë të cmimeve specifike të shitjes të shoqërisë.

Megjithatë, për qiratë e pasurive, shoqëria ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit jo-qira dhe të regjistrojë komponentët e qirasë dhe jo- qirasë si një komponent i vetëm i qirasë.

C. Qiradhëniet e klasifikuara si qira operative nën SNK 17

Më parë, Shoqëria i klasifikonte qiratë e pasurive si qira operative nën SNK 17. Me aplikimin e SNRF 16, detyrimet e qirasë u matën me vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, të skontuara me normën rritëse të huamarrjes të kompanisë më 1 janar 2019. Aktivitetet me të drejtë përdorimi maten ose me:

— vlerën kontabël të tyre sikur SNRF 16 të ishte aplikuar që nga data e fillimit, skontuar me normën rritëse të huamarrjes të kompanisë në datën e aplikimit fillestar: Shoqëria aplikoi këtë qasje për qiratë më të mëdha të shoqërisë. ose

— një shumë e barabartë me detyrimin e qirasë, rregulluar nga shuma e çdo pagese të parapaguar ose të llogaritur të qirasë: Shoqëria zbatoi këtë qasje në të gjitha qiratë e tjera.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**3.13 Miratimi i Standardeve dhe Interpretimeve të Reja ose të Rishikuara****SNRF 16, Qiratë****C. Ndikimi në pasqyrat financiare****a. Ndikimi në tranzicion**

Shoqëria ka aplikuar për here të parë SNRF 16 në 1 janar 2019, për kontratat aftagjata të qirasë për zyrat dhe magazinën. Me kalimin në SNRF 16, shoqëria njohu aktive shtesë të së drejtës së përdorimit, përfshirë aktivet aftagjata t; investuara, dhe detyrime shtesë të qirasë, duke njohur ndryshimin në fitimin e pashpërndarë. Ndikimi I aplikimit të SNRF 16 është përmbledhur më poshtë.

Në mijë Lek	31 Dhjetor 2019
Aktive me të drejtë përdorimi – Ndërtesa	9,039,865
Aktive me të drejtë përdorimi – Mjete motorike dhe të tjera	12,510,570
Detyrimet e qirasë	11,694,226

Shumat e njohura në fitim ose humbje 2019 - Qira nën SNRF 16	Në Lek
Tarifa e zhvlerësimit për aktivet e përdorimit të së drejtës (shiko shënimin 6)	(9,701,903)
Kamata për detyrimet e qirasë	0
2019 - Qiratë operative sipas SNK 17	
Shpenzimet e qirasë (shiko shënimin 18)	12,459,623

b- Qiratë*Politika e zbatueshme nga 1 janari 2019*

Në fillimin e një kontrate, Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe. Për të vlerësuar nëse një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, Shoqëria përdor përkufizimin e qirasë në SNRF 16. Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura, në ose pas 1 janarit 2019.

Si qiramarrës

Me fillimin ose me modifikimin e një kontrate që përmban një komponent të qirasë, Shoqëria shpërndan vlerësimin në kontratë për secilin përbërës të qirasë në bazë të cmimeve specifike të shitjes të shoqërisë. Megjithatë, për qiratë e pasurive, shoqëria ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit jo-qira dhe të regjistrojë komponentët e qirasë dhe jo- qirasë si një komponent i vetëm i qirasë.

Shoqëria njeh një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesa të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të ndodhur dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen e aktivin bazë ose për të rivendosur aktivin bazë në kushtet e kërkuara, minus çdo stimul qiraje të marrë.

Aktivi me të drejtë përdorimi zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën e lineare nga data e fillimit deri në fund të afatit të qirasë, përveç nëse qiraja transferon pronësinë e aktivit bazë tek Shoqëria deri në fund të afatit të qirasë ose kostoja e aktivit të së drejtës së përdorimit pasqyron që Shoqëria do të ushtrojë një opsion blerjeje. Në këtë rast, aktivi i të drejtës së përdorimit do të zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktivit bazë, i cili përcaktohet në të njëjtën bazë si ato të pasurive dhe pajisjeve. Për më tepër, aktivi me të drejtë përdorimi zvogëlohet në mënyrë periodike nga humbjet e zhvlerësimit, nëse ka, dhe rregullohet për rivlerësime të caktuara të detyrimit të qirasë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.13 Miratimi i Standardeve dhe Interpretimeve të Reja ose të Rishikuara (vazhdim)

b- Qiratë

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në datën e fillimit, skontuar me normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, norma rritëse e huamarrjes së kompanisë. Në përgjithësi, Shoqëria përdor normën e saj të huamarrjes si norma e skontimit.

Shoqëria përcakton normën rritëse të huamarrjes duke marrë norma interesi nga burime të ndryshme të financimit të jashtëm dhe bën rregullime të caktuara për të pasqyruar kushtet e qirasë dhe llojin e aktivitetit të marrë me qira.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë pagesat për të drejtën e përdorimit të aktivitetit bazë gjatë afatit të qirasë, të papaguara në datën e fillimit si më poshtë:

- pagesat fikse përfshirë pagesat fikse në-thelb;
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit;
- shumat që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerje nëse qiramarrësi është mjaft i sigurt për ta ushtruar këtë opsion, pagesa të qirasë në një periudhë rinovimi opsionale nëse Shoqëria është e sigurt për të ushtruar një mundësi shtesë, dhe gjopa për përfundimin e parakohshëm të qirasë, përveç nëse Shoqëria është me siguri të arsyeshme që të mos e ndërpresë herët.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Shoqërisë për shumën që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur, nëse Shoqëria ndryshon vlerësimin e saj nëse ajo do të ushtrojë një mundësi blerjeje, zgjatjeje ose përfundimi ose nëse ka një pagesë të rishikuar të qirasë fikse në-thelb.

Si qiramarrës

Kur detyrimi i qirasë është ri-matur në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël të aktivitetit të së drejtës së përdorimit, ose regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e aktivitetit të së drejtës së përdorimit është zvogëluar në zero.

Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët

Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë aktivitetet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë për qira të aktiveve me vlerë të ulët dhe qira afatshkurtra, përfshirë pajisjet IT. Shoqëria njeh pagesat e qirasë që lidhen me këto qira si një shpenzim në bazë lineare për periudhën e qirasë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.13 Miratimi i Standardeve dhe Interpretimeve të Reja ose të Rishikuara (vazhduar)

Si qiramarrës

i. Si qiramarrës

Në periudhën krahasuese, si qiramarrëse, Shoqëria klasifikoi qiratë që transferojnë në mënyrë të konsiderueshme të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë si qira financiare. Nëse ky ishte rasti, aktivet e marra me qira u matën fillimisht në një shumë të barabartë me vlerën e tyre të drejtë dhe vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë. Pagesat minimale të qirasë ishin pagesa për afatin e qirasë që qiramarrësit i kërkohej të bënte, duke përjashtuar çdo qira të kushtëzuar. Pas njohjes fillestare, aktivet u llogaritën në përputhje me politikën e kontabilitetit të zbatueshme për atë aktiv.

Pasuritë e mbajtura nën qiratë e tjera janë klasifikuar si qira operative dhe nuk janë njohur në pasqyrën e pozicionit financiar të Kompanisë. Pagesat e bëra nën qiradhëniet operative u njohën në fitim ose humbje në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Stimujt e marrë të qirasë u njohën si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019),
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),

Zbatimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në pasqyrat financiare të Shoqërisë, përveç SNRF 16 impakti i të cilës në Pasqyrat Financiare është përmendur më lart.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3.14 Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi:

- **SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”** (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinimet e Biznesit”** - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).
- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet Financiarë”, SNK 39 “Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiarë: Shpalosjet”** - Reforma e Standardit të Normave të Interesit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020),
- **Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta”** - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” dhe SNK 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet”** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),
- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”** - Klasifikimi i Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2022),
- **Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

4. GJYKIME DHE VLERËSIME KRITIKE TË KONTABILITETIT

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmerite e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme për rrethanat. Drejtimi gjithashtu bën gjykimet të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Vendimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një ndryshim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

4.1 Parimi I vijimësisë.

Drejtimi i përgatiti këto pasqyra financiare jo mbi parimin e vijimësisë. Në këtë gjykim Drejtimi konsideroi qëllimet aktuale të Shoqërisë, përfitueshmërinë e aktivitetit dhe analizoi impaktin e zhvillimeve makro ekonomike në aktivitetin e Shoqërisë së bashku me marrëveshjen kontraktuale. Sipas marrëveshjes së koncesionit të datës 03 shtator 2009, data e maturimit të periudhës së koncesionit është 31 dhjetor 2020. Pas maturimit, shoqëria do t'i transferojë pa pagesë Autoritetit Kontraktues pronësinë mbi QKT e re, QKTL si dhe mbi të gjitha pajisjet elektromekanike dhe kompjuterike (si ato të QKT eksistuese ashtu dhe ato të QKT të re si dhe QKTL) si dhe, në çdo rast, do të kryejë të gjitha ato veprime të cilat janë pazgjydhshëmrisht të lidhura me veprimet e transferimit/kalimit të pronësisë dhe të nënshkruajë të gjitha aktet që do të bëjnë të mundur këtë kalim pronësie siç shpjegohet në Shënimin 1.1 të Pasqyrave Financiare. Si e tillë, të gjitha zërat në pozicionin financiar paraqiten si afatshkurtra dhe të matur me vlerën neto të realizueshme. Ekziston një pasiguri materiale e lidhur me përfundimin e Marrëveshjes së Koncesionit më 31 Dhjetor 2020 e cila mund të ngrejë dyshim të konsiderueshëm në aftësinë e Shoqërisë për të zbatuar parimin e vijimësisë. Rëndësia e një ngjarje të tillë mund të mitigohet nga planet e drejtimit për vazhdimin e marrëveshjes me Autoritetin Kontraktues mbi ofrimin e shërbimit të kontrollit teknik për një periudhë shtesë.

4.2 Gjykimet të tjera në zbatimin e politikave të kontabilitetit

Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Shqipëri dhe globalisht mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime të cilat mund të çojnë në rregullime materiale të vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti Drejtimi pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e rikuperueshmërisë së aktiveve, lindja e detyrimeve të reja dhe përllogaritjet kontabël të preken. Në këtë fazë Drejtimi nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin pasi ngjarjet lidhur me Covid -19 po sjellin zhvillime të reja dita-ditës. Ndikimi afatgjatë mund të ndikojë gjithashtu në vëllimet e tregtimit, flukset e parave, dhe përfitueshmërinë e Shoqërisë. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Shoqërisa vazhdon të përmbushë detyrimet e saj sipas kushteve dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë politikat e kontabilitetit siç përcaktohen në këto pasqyra financiare.

SGS Automotive Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të vecanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2019

(shumat janë të shprehura në LEK)

5. AKTIVET AFATGJATA JO MATERIALE

Aktivët afatgjata jomateriale si më 31 Dhjetor, 2019 dhe 2018 përbëhen nga:

<i>Kosto</i>	Pajisje IT	Të tjera	Rinvestime	Totali
Më 1 Janar, 2018	376,069,744	484,729,451	109,214,522	970,013,717
Shtesat	633,377	298,742	-	932,119
Pakësimet	(633,377)	-	-	(633,377)
Më 31 Dhjetor, 2018	376,069,744	485,028,193	109,214,522	970,312,459
Shtesat	704,608	187,617	13,057,993	13,950,218
Pakësimet	(3,504,528)	-	(13,057,993)	-16,562,521
Më 31 Dhjetor, 2019	373,269,824	485,215,810	109,214,522	967,700,156
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Më 1 Janar, 2018	292,330,988	391,697,912	90,522,997	774,551,897
Amortizimi i vitit	50,074,539	55,787,248	10,680,872	116,542,659
Pakësimet	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor, 2018	342,405,527	447,485,160	101,203,869	891,094,556
Amortizimi i vitit	34,206,703	37,711,913	8,010,653	79,929,268
Pakësimet	(3,504,526)	-	-	(3,504,526)
Më 31 Dhjetor, 2019	373,107,704	485,197,073	109,214,522	967,519,299
Vlera neto kontabël				
Gjendja në Janar, 2018	83,738,756	93,031,539	18,691,525	195,461,820
Gjendja në 31 Dhjetor, 2018	33,664,217	37,543,033	8,010,653	79,217,903
Gjendja në 31 Dhjetor, 2019	162,120	18,737	-	180,857

Gjendja në 31 Dhjetor, 2019, shoqëria nuk ka aktive të vendosura si kolateral apo garanci (31 Dhjetor 2018, asnjë)

6. E DREJTA E PËRDORIMIT TË AKTIVEVE, NETO

	Ndërtesat	Automjete	Totali
Kosto			
Më 1 janar 2019	4,357,137	2,197,082	6,554,220
Shtesat	4,682,728	12,510,570	17,193,298
Pakësimet	-	(2,197,082)	(2,197,082)
Më 31 dhjetor 2019	9,039,865	12,510,570	21,550,435
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 janar 2019	-	(7,379,052)	-
Amortizimi i vitit	(4,519,933)	2,197,082	(11,898,985)
Pakësimet	-	(5,181,970)	2,197,082
Më 31 dhjetor, 2019	(4,519,933)	(7,379,052)	(9,701,903)
Vlera neto kontabël			
Më 1 Janar, 2019	4,357,137	2,197,082	6,554,219
Më 31 Dhjetor, 2019	4,519,932	7,328,600	11,848,532

Shoqëria merr me qira disa aktive duke përfshirë ndërtesa dhe automjete.

7. INVENTARI

Inventari më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 është e përbërë si më poshtë:

	As at December 31 2019	As at December 31 2018
Çertifikatat e inspektimit dhe të tjera	1,551,050	1,657,043
Materiale ndihmëse dhe konsumi	8,131,027	1,686,414
TOTALI	9,682,077	3,343,457

8. LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE TË TJERA

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera si më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme		
Debitorët vendas	63,090	108,454
Të arkëtueshme nga kompanitë e sigurimit	1,609,288	-
Totali i llogarive të arkëtueshme	1,672,378	108,454
Të arkëtueshme të tjera afatgjata		
Shpenzime të shtyra	6,900,972	4,688,084
Detyrime nga punonjësit	56,220	56,220
TVSH e zbritshme	13,016	1,516
Totali i të arkëtueshmeve të tjera	6,970,208	4,745,820
Totali i llogarive të arkëtueshme dhe të tjera	8,642,586	4,854,274

Shpenzime të shtyra përbëhen kryesisht nga kostot e kalibrimit nga Maha dhe kostot e mirëmbajtjes të website nga Oracle

9. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 Dhjetor, 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Llogari bankare në monedhën vendase	363,121,398	298,727,796
Depozita bankare në monedhën vendase	160,641,793	170,107,669
Llogari bankare në monedhë të huaj	1,051,713	496,049
Para në arkë në monedhën vendase	6,325,888	4,101,408
Para në arkë në monedhën të huaj	8,461	2,020
Totali	531,149,253	473,434,942

Depozita bankare në monedhën vendase janë llogari kursimi të quajtura “Elastike” që i japin shoqërisë të drejtën për të depozituar dhe tërhequr para në çdo kohë.

10. KAPITALI AKSIONAR

Më 31 Dhjetor, 2019 shuma e kapitalit aksionar është 190,000,100 Lek (2018: 190,000,100 Lekë) dhe përbëhet nga 1,900,001 aksione (2018: 1,900,001) me një vlerë nominale 100 Lek për aksion, , të zotëruara tërësisht nga SGS Société Générale De Surveillance S.A. e cila është ortak kryesor dhe pala e vetme kontrolluese.

11. LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA

Llogari të pagueshme dhe të tjera më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 që përbëhet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Llogari të pagueshme		
Furnitor vendas	3,313,796	1,264,323
Furnitor të huaj	40,928,543	39,072,005
Total i llogarive të pagueshme	44,242,339	40,336,328

Të pagueshme të tjera

TVSH e pagueshme	20,545,100	20,359,840
Të pagueshme ndaj punonjësve	24,560,431	18,702,947
Të pagueshme të tjera	12,420,294	798,298
Shpenzime të përlllogaritura	4,426,722	4,043,186
Provigjone për çështje ligjore	5,842,640	-
Total i të pagueshmeve të tjera	67,795,187	43,904,271
TOTALI	112,037,526	84,240,599

	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Lëvizjet në provigjone		
Shtesat më 1 Janar	-	7,145,407
Shtesat e provigjoneve	5,842,640	
Përdorimi i provigjoneve	-	(3,695,900)
Anulimet		(3,449,507)
Shtesat 31 Dhjetor	5,842,640	-

11. LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA (VAZHDIM)

SGS Automotive Albania ka krijuar një provigjon në 2019 për çështjet ligjore në lidhje me përfundimin e punësimit për një ish-punonjës në shumën 2,304,892 Lek. Gjithashtu një provigjon përsa I përket gjobave të vendosura nga Kontrolli Tatimor që shoqëria pati për periudhën Qershor 2014 – Qershor 2019, në shumën 3,537,747 Lek. Shuma 4,794,640 Lek është gjobë mbi tatim fitimin, I prezantuar në notën e tatim fitimit.

Të tjera të pagueshme përbëhen nga të pagueshme ndaj shtetit për sigurime shoqërore, tatimi mbi të ardhurat personale, tatim në burim dhe të pagueshme ndaj Drejtorisë së Transportit Rrugor.

12. DETYRIMET KONTRAKTUALE

Detyrimet kontraktuale më 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Detyrimet kontraktuale	5,246,674	3,848,187
TOTALI	5,246,674	3,848,187
	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Lëvizjet në detyrimet kontraktuale		
Balanca hapëse	3,848,187	2,274,882
Parapagimet përgjatë vitit	9,674,075	9,452,982
Shërbimet dhënë klientëve gjatë vitit	(8,275,588)	(7,879,677)
Balanca Mbyllëse	5,246,674	3,848,187

Detyrimet kontraktuale paraqesin shumën e parapagimeve që Shoqëria ka më 31 Dhjetor, 2019. Shërbimi i inspektimit të automjeteve u jepet vetëm atyre që kanë paguar tarifën (e përcaktuar në kontratën e konçesionit). Si pasojë, sipas kërkesës të institucioneve qeveritare por gjithashtu të kompanive private që duan të bëjnë pagesa bankare, një faturë parapagimi lëshohet për automjetet që do testohen gjatë vitit. Në momentin që automjeti i listuar në faturë vjen për kontroll teknik, shoqëria lëshon një faturë zbritje, duke rikuperuar të ardhurën relevante. Aktualisht në këtë zë përfshihen të gjitha automjetet për të cilat është lëshuar një faturë parapagimi, por nuk janë siguruar me shërbimin brenda vitit 2019.

13. VLERA E RIINVESTIMIT

Më 31 Dhjetor, 2019 dhe 2018, lëvizjet në detyrimin për riinvestim prezantohet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor, 2018
Më 1 Janar	80,977,361	121,927,105
Reduktim në vlerën e riinvestimit si pasojë e kostove të mirëmbajtjes (shiko notën 15)	-	(40,316,366)
Reduktim në vlerën e riinvestimit si pasojë e shtesave në aktive (shiko notën 5)	(13,057,992)	(633,378)
Reduktim në vlerën e riinvestimit si pasojë e pagesave	(56,100,300)	-
TOTALI	11,819,069	80,977,361

13. VLERË E RIINVESTIMIT (VAZHDIM)

Detyrimi aktual për të riinvestuar 30.7% të investimit total është njohur si një detyrim afatgjatë, meqenëse daljet e burimeve që përfaqësojnë përfitime ekonomike, do të nevojiten për të mbyllur detyrimin në tre vitet e fundit të periudhës së marrëveshjes. Në shtator 2016, Shoqëria ka vlerësuar vlerën aktuale të detyrimit për shumën e riinvestimit në 172,000,000 Lekë, (që përfaqëson vlerën 30.7% të vlerës së investimit) dhe duke filluar nga shtatori 2016, të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes dhe blerjes së aktiveve do të shkojnë në uljen e vlerës së detyrimit të riinvestimit.

Kjo realizohet përmes blerjes së aktiveve të reja dhe mirëmbajtjes së aktiveve ekzistuese. Shuma e përgjithshme e riinvestimeve gjatë vitit 2019 arriti në 40,949,744 Lek (2018: 41,093,411 Lek) përbërë nga kostot e mirëmbajtjes 40,316,366 Lek (2018: 36,769,924 Lek) dhe blerja e aktiveve 633,378 Lek (2018: 4,296,487 Lek), pas maturimit të detyrimit për vlerën e riinvestimit.

Sipas nenit të kontratës së koncesionit nr.8.5, njësia ekonomike i ka paguar Qeverisë një shumë prej 56,100,300 Lekë, për shkak se kompania nuk arrin të ri-investojë plotësisht ose pjesërisht shumën e riinvestimit deri në katër muaj para përfundimit të Periudhës së Koncesionit.

14. DETYRIME QIRAJE

Detyrime qiraje më 31 Dhjetor, 2019 dhe 31 Dhjetor, 2018 detajohen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor, 2018
Afatshkurtra	11,694,226	-
Detyrime qiraje	11,694,226	-

15. TË ARDHURAT NGA KONTRATAT ME KLIENTËT

Analiya e të ardhurave sipas kategorisë përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga kontratat me klientët	970,401,001	944,982,770
TOTALI	970,401,001	944,982,770

Kontratat me klientët përmbajnë një detyrim të vecantë përformance: kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve. Shërbimet e ofruara nga Shoqëria janë zakonisht specifike për cdo klient dhe pa ndonjë përdorim alternative për Shoqërinë (Shoqëria nuk mund ta ridrejtojë një shërbim tek një klient tjetër nëse një klient anulon kontratën). Duke qenë se Shoqëria ka të drejtën e pagesës për shërbimet e kryera në një kohë të caktuar, kushti I njohjes së të ardhurës përgjatë kohës plotësohet dhe SNRF 15 jep një lehtësi praktike për të njohur të ardhurat bazuar në pagesën që Shoqëria pret të marrë në fund të periudhës.

E ardhura totale e deklaruar në deklaratat e TVSH është 971,812,905 lekë, sipas të ardhurave nga ofrimi i shërbimit të kontrollit teknik.

Nga shitja e shërbimit Shoqëria ka njohur si të ardhura të shtyra vlerën prej 1,765,088 lekë (2018: 1,573,304 lekë) e cila është vlerë e lidhur me shërbimet e faturuara dhe të likuiduara por që nuk u janë ofruar klientëve brenda vitit ushtrimor, ju lutemi për më shumë detaje referojuni shënimit 12.

Nga të ardhurat e shtyra të vitit 2016 - të ardhurat në një shumë prej 366,000 lekësh janë njohur si të ardhura gjatë vitit 2019.

16. MATERIALET DHE MATERIALET E KONSUMIT TË PËRDORURA

Materiali dhe materialet e konsumit të përdorura gjatë vitit 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Energji, ujë dhe naftë	8,779,969	8,047,748
Materiale ndihmëse dhe material konsumi që lidhen me shërbimet	7,379,667	7,139,491
Të tjera	389,347	1,056,989
TOTALI	16,548,983	16,244,228

17. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit të bëra gjatë vitit 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Pagat bruto	186,966,072	183,709,306
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	27,631,595	26,914,352
Akruali i bonusit dhe shpenzime të tjera personeli	17,884,135	2,238,668
TOTALI	232,481,802	212,862,326

18. SHPENZIMET OPERATIVE TË TJERA

Shpenzimet operative të tjera përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime të tjera për sigurinë, ndërmjetësimin dhe konsulencën	88,031,865	82,593,578
Shpenzimet që lidhen me licencën	75,788,213	76,360,219
Gjobat ii	12,731,844	51,091,005
Tarifa e koncesionarit	48,589,806	47,327,657
Marketing dhe promocion	44,802,790	46,761,686
Shpenzime qiraje i	778,538	11,156,395
Taksa dhe tarifa	4,439,338	6,650,752
Shpenzime Transporti	7,218,110	5,844,634
Sigurim	5,664,897	5,609,359
Kosto mirëmbajtje iii	41,508,938	4,028,772
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	847,761	3,992,849
Shpenzime telekomunikacioni	3,192,441	3,198,877
Furnizime zyre	2,994,632	2,889,663
Shpenzime bankare	474,012	474,156
Shpenzime prezantimi, dhurata	337,790	327,812
Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare	78,564	125,946
Kthimi i Provigjionit për çështjet gjyqësore	-	(3,254,507)
Shpenzime të tjera	1,882,448	2,658,837
TOTALI	339,361,987	347,837,690

18. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE (VAZHDIM)

i. Shpenzime qiraje

Më 1 Janar 2019, Shoqëria ka aplikuar SNRF 16. Efekti I adoptimit të SNRF 16 është prezantuar në shënimin 7 dhe shënimin 12. Ju lutem referojuni ndryshimeve të mëposhtme për prezantimin e shpenzimeve të qirasë sipas SNRF 16;

Efekti për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor, 2019	SBRF 16	SNK 17
Totali pagesave ndaj qiradhënësit	12,459,623	12,459,623
Ulja e detyrimeve të qirasë	(11,681,085)	-
Rent	778,538	12,459,623

ii. Gjobat

Në 2019, gjobat në vlerën 12,731,844 Lek përfaqësojnë një gjobë të vendosur nga Kontrolli Tatimor, që kompania kishte për periudhën Qershor 2014 - Qershor 2019. Në 2018, gjobat në vlerën 51,091,005 lekë paraqesin një gjobë të vendosur nga Autoriteti i Konkurrencës (AK), për abuzim të mundshëm të Kompanisë me pozicionin mbizotërues në treg (shiko shënimin 18).

iii. Kostot e mirëmbajtjes

Në shpenzimet e mirëmbajtjes përfshihen kostot e mirëmbajtjes të njohura si ulje në provizionin e riinvestimeve 0 Lek për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019 (2018: 40,316,366 Lek) e përbërë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Kostot e mirëmbajtjes të bëra gjatë vitit	41,508,938	44,345,138
Minus, kostot e mirëmbajtjes të njohura si zvogëlim i provizionit për riinvestime (shiko shënimin 11)	0	(40,316,366)
Shpenzimet e mirëmbajtjes të ngarkuara në fitim ose humbje për vitin	41,508,938	4,028,772

19. TË ARDHURAT FINANCIARE NETO

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare janë detajuar më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat financiare		
Të ardhurat nga interesi	-	4,791
Të ardhura të tjera financiare	89,763	80,600
Totali I të ardhurave financiare	89,763	85,391
Shpenzimet financiare		
Mosbindja e zbritjes	-	-
Totali I shpenzimeve financiare	-	-
Financial income/(expenses), net	89,763	85,391

Në çdo periudhë raportuese, Shoqëria llogarit një interes në balancën hapëse të provizionit që përfaqëson " ndikimin e vlerës në kohë të ndryshimit të normave të aktualizimit " në përputhje me KIRFN 1. Në 2019 efekti i këtij ndikimi është zero. Shtesat e lidhura me skontimin e vlerës së riinvestimit gjatë 2019 janë zero.

20 FITIM/ HUMBJET NGA KURSI I KEMBIMIT

Fitim/humbja nga kursi i këmbimit detajohet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitim/humbja nga kursi i këmbimit		
Humbjet nga kursi i këmbimit	(860,343)	(1,158,042)
Fitimet nga kursi i këmbimit	673,749	1,830,572
Total (Humbje)/Fitime nga kursi i këmbimit	(186,594)	672,530

21. TATIM FITIMI

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	%	Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor, 2018	%
Fitimi para tatimit	293,587,673	100%	252,253,787	100%
Taksë mbi të ardhurat sipas normës tatimore në fuqi	44,038,151	15%	37,838,068	15%
Shpenzimet e pazbritshme	18,190,400	6%	22,171,475	9%
Shpenzimi I tatim fitimit	62,228,551	21%	60,009,543	24%

Lista e shpenzimeve të pazbritshme:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjobat	12,779,229	51,130,425
Shpenzimet e personelit	14,574,709	5,192,956
Shpenzimet e tjera	47,707,994	49,354,674
Amortizimi	38,137,743	71,322,622
Axhustime lidhur me vlerën e riinvestimit:		
Amortizimi i vlerës së riinvestimit (shënimi 5)	8,010,654	10,680,872
Kosto mirëmbajtje të njohura si reduktim në provizionin për riinvestimin (shënimi 15)	-	(40,316,366)
Ndikimi i vlerës në kohë të ndryshimit të normave të aktualizimit (shënimi 16)	-	-
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme (shiko shënimin 15)	78,564	125,946
Dhuratat	205,940	318,702
Efekti I SNRF 16	(225,497)	
Total I shpenzimeve të pazbritshme	121,269,336	147,809,831

Lëvizjet në tatimin e pagueshëm mbi fitimin paraqiten si më poshtë:

		Viti i mbyllur më 31 dhjetor	
	Norma e taksës	2019	2018
Fitimi para tatimit		293,587,673	252,253,787
Shpenzimet e pazbritshme		121,269,336	147,809,831
Të ardhurat e taksueshme		414,857,009	400,063,618
Norma e taksës	15%	62,228,551	60,009,543
Tatimi i parapaguar		62,881,962	50,469,458
Tatimi mbi fitimin I pagueshëm/ I arkëtueshëm		(653,411)	9,540,085

22. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË ARDHSHME*Angazhimet*

Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale të kontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, që nuk janë njohur tashmë në pasqyrat financiare.

Detyrimet e taksave

Për periudhën Qershor 2014 - Qershor 2019, regjistrimet dhe librat e kompanisë janë kontrolluar nga autoritetet tatimore. Sipas raportit tatimor dhe totalit të detyrimeve, gjobave dhe interesave të detyrimeve të vendosura nga autoritetet tatimore, Shoqëria ka njohur një provigjon për detyrimet dhe i ka kaluar në pasqyrën e fitim-humbjes.

Çështje gjyqësore

Gjatë 2019 Kompania ka qenë subjekt i disa çështjeve gjyqësore me ish-punonjës. Gjithë këto çështje janë akoma në proces apelimi, dhe kompania ka provigjonuar pjesërisht detyrimet e ardhshme nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën 2,304,892 Lek.

Gjithashtu një provigjon në lidhje me gjobat e vendosura nga autoritete tatimore, bazuar në kontrollin që kompania kishte për periudhën Qershor 2014 - Qershor 2019, në shumën 3.537,747 lekë. Shuma prej 4,794,640 lekësh është gjoba për tatimin mbi të fitimin, i cili paraqitet në shënimin e tatimit mbi të fitimin. Drejtimi beson që rezultati i ardhshëm i këtyre padive nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në performancën financiare dhe aktivitetet e Shoqërisë.

23. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Transaksionet e palëve të lidhura për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të ardhura	Shpenzime
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019				
SGS Albania	-	-	1,920	-
SGS Group Management	-	251,984	-	75,644,649
SGS Greece	-	-	-	283,919
SGS Bulgaria	-	440,564	-	443,494
Genilink	-	101,473	-	307,051
Shpenzime për drejtuesit kryesorë	-	-	-	12,981,840
Totali	-	794,021	1,920	89,660,954

	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të ardhura	Shpenzime
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019				
SGS Albania	-	-	1,920	-
SGS Group Management	-	251,984	-	75,644,649
SGS Greece	-	-	-	283,919
SGS Bulgaria	-	440,564	-	443,494
Genilink	-	101,473	-	307,051
Shpenzime për drejtuesit kryesorë	-	-	-	12,981,840
Totali	-	794,021	1,920	89,660,954

Shoqëria mëmë përfundimtare dhe kontrolluese e shoqërisë është SGS Societe General De Surveillance s.a me seli në Gjenevë, Zvicër.

24. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**24.1 Faktorët e rrezikut financiar**

Aktiviteti i Shoqërisë e ekspozon atë ndaj disa rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë, rrezikun nga kurset e këmbimit dhe rrezikun e normave të interesit. Administrimi i rrezikut të Shoqërisë përqëndrohet në paparashikueshmërinë e tregut dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

Administrimi i rrezikut bëhet nga drejtimi duke u bazuar në disa politika e procedura të shkruara dhe të aprovuara, të cilat mbulojnë të gjithë administrimin e rrezikut dhe pjesë specifike si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normave të interesit, rreziku i kredisë dhe rreziku i likuiditetit.

24.2 Rreziku i tregut*Rreziku nga kurset e këmbimit*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen prej ekspozimit ndaj monedhave të huaja, kryesisht ndaj monedhës Euro. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një pozicion të përshtatshëm neto në çdo monedhë dhe në total si dhe të monitorojë operacionet me bazë ditore.

Vlera e mbartur e aktiveve dhe detyrimeve të Shoqërisë në monedhë të huaj paraqitet si më poshtë:

	Vlera kontabël			
31 Dhjetor 2019	2019	EUR	USD	LEK
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	531,149,253	1,051,713	-	530,097,540
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	8,642,586	2,710,177	2,134,646	3,797,763
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(117,284,200)	(11,262,520)	-	(106,021,680)
Ekspozimi neto	422,507,639	(7,500,630)	2,134,646	427,873,623

	Vlera kontabël			
Më 31 dhjetor 2018		EUR	USD	LEK
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	473,434,942	498,069	-	472,936,873
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	4,854,274	2,393,408	818,701	1,642,165
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(88,088,786)	6,166,623	-	(94,255,409)
Ekspozimi neto	390,200,430	9,058,100	818,701	380,323,629

Analiza e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimi

Në administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit Shoqëria ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kurseve të këmbimit mund të kenë ndikim në fitim. Një analizë e ndikimit të ndryshimeve në përqindjen e luhatjeve të vlerës së Lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur më poshtë.

Analiza e ndjeshmërisë së mëposhtme është zhvilluar duke u bazuar në ekspozimin ndaj kursit të këmbimit në datën e raportimit dhe ndryshimit të përcaktuar i cili ndodh në fillim të vitit financiar dhe mbahet konstant gjatë gjithë periudhës raportuese. Më poshtë paraqitet analiza e efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit.

24 ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**24.2 Rreziku tregtar (vazhdim)**

Analiza e ndjeshmërisë së mëposhtme është zhvilluar duke u bazuar në ekspozimin ndaj kursit të këmbimit në datën e raportimit dhe ndryshimit të përcaktuar i cili ndodh në fillim të vitit financiar dhe mbahet konstant gjatë gjithë periudhës raportuese. Më poshtë paraqitet analiza e efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit në fitimin apo humbjen dhe kapitalit neto mbas tatimit, duke supozuar se të gjithë faktorët e tjerë në veçanti normat e interesit, janë konstante:

	2019	2018
EUR vlerësohet 10%	750,063	905,810
EUR zhvlerësohet 10%	(750,063)	(905,810)
USD vlerësohet 10%	21,364	81,870
USD zhvlerësohet 10%	(21,364)	(81,870)

Fluksi i mjeteve monetare dhe rreziku i normave të interesit me vlerë të drejtë

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit meqenëse nuk ka detyrime me norma të luhatshme interesi.

24.3 Rreziku i kreditit

Rreziku kreditor është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë është ndikuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient.

Shoqëria ka vendosur politika për t'u siguruar që shërbimet të ofrohen pas një parapagimi nga klientët. Kjo politikë kufizon shumën e ekspozimit ndaj një pale tjetër. Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Shoqëria krijon një provizion për zhvlerësimin që përfaqëson vlerësimin e humbjeve nga llogaritë e arkëtueshme duke u bazuar në humbje specifike të lidhura me ekspozime të rëndësishme individuale.

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut kreditor përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

Pjekuria	0-60	61-90	91-120	121-180	181-240	241-300	301-360	>360	Total
Llogari të arkëtueshme (bruto)	43,300	2,950	0	5,900	7,640	15,620	16,710	170,480	
Rrjet koordinativ 2 (shënim 3.3)	0%	0.5%	15%	30%	50%	75%	100%	100%	
Humbja e pritshme e kredisë	0	15	0	1,770	3,820	11,715	16,710	170,480	204,510

Pjekuria	0-60	61-90	91-120	121-180	181-240	241-300	301-360	>360	Total
Llogari të arkëtuesh (bruto)	63,560	1,960	1,960	19,440	46,960	15,320	12,590	72,250	
Rrjet koordinativ 2 (shënim 3.3)	0%	0.5%	15%	30%	50%	75%	100%	100%	
Humbja e pritshme e kredisë	0	10	294	5,832	23,480	11,490	12,590	72,250	125,946

24 ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**24.3 Risku I kreditit (vazhdim)**

Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e secilës pasuri financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, siç përmbledhet më poshtë:

	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor, 2018
Klasat e pasurive financiare - vlera kontabël:		
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	4,854,274	4,854,274
Mjete monetare dhe ekuivalente	473,434,942	473,434,942
	478,289,216	478,289,216

Rreziku kreditor për mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre konsiderohet i papërfillshëm, meqenëse palët respektive janë banka me reputacion të mirë dhe me një cilësi të lartë të vlerësimit të rrezikut të kredisë.

24.4 Risku I likuiditetit

Shoqëria i drejton nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e huave të skeduluara dhe duke parashikuar hyrjet dhe daljet e parave bazuar në rrjedhën e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditet monitorohen në grupime të ndryshme kohore. Nevojat neto për mjete monetare në arkë krahasohen me mjetet e disponueshme të huamarrjes në mënyrë që të përcaktohet çdo humbje. Kjo analizë tregon nëse mjetet e disponueshme të huamarrjes janë të mjaftueshme për periudhën në shqyrtim. Shoqëria mban para në arkë dhe bankë për të përmbushur nevojat e saj për likuiditet për një periudhë minimale prej 30 ditësh.

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë kanë maturime kontraktuale si më poshtë:

Më 31 Dhjetor, 2019	1 deri në 12 muaj	Total
Mjete monetare dhe ekuivalente	531,149,253	531,149,253
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	8,642,586	8,642,586
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(117,284,200)	(117,284,200)
Hapësira e likuiditetit neto	422,507,639	422,338,833
Më 31 Dhjetor, 2018	1 deri në 12 muaj	Total
Mjete monetare dhe ekuivalente	473,434,942	473,434,942
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	4,854,274	4,854,274
Llogari të pagueshme dhe të tjera	(88,088,786)	(88,088,786)
Hapësira e likuiditetit neto	390,200,430	390,200,431

Shumat e mësipërme reflektojnë flukset kontraktuale të parasë të paskontuara, të cilat mund të ndryshojnë nga vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve në datën e raportimit.

24 FINANCIAL RISK MANAGEMENT (CONTINUED)**24.5 Rreziku I menaxhimit të kapitalit**

Objektivat e Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë vazhdimësinë e Shoqërisë për të siguruar kthime për aksionarët dhe përfitime për palët e tjera si dhe të mbajë një strukturë optimale kapitali për të pakësuar kostot e kapitalit. Për të ruajtur ose përshtatur strukturën e kapitalit, Shoqëria mund të përshtasë sasinë e dividendëve të paguar, të bëjë shtesa në kapitalin e nënshkruar dhe të paguar, ose të shesë aktive për të pakësuar borxhin.

24.6 Vlerësimi I vlerës së drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson çmimin që do të merret për të shitur një aktiv ose çmimin që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion normal ndërmjet pjesëmarësve në treg në datën e matjes

24.7 Instrumentat financiarë të prezantuar në vlerën e drejtë

Aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë e cila grupon aktivet dhe detyrimet financiare në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të instrumentave financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si vijon:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë të mundshme për vëzhgimin e aktiveve dhe detyrimeve, në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh. si çmime), ose jo të drejtpërdrejtë (p.sh. të përbëra nga çmimet) dhe;
- **Niveli 3:** të dhëna për aktivin ose detyrimin të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna të disponueshme nga mbikqyrja e tregut.

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë është përcaktuar duke përdorur të dhënat e nivelit të 2 dhe nuk ka riklasifikime ndërmjet niveleve të vlerës së drejtë. Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta ndaj atyre aktiveve dhe detyrimeve financiare që nuk paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera kontabël		Vlera e drejtë	
	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor, 2018	Më 31 Dhjetor, 2019	Më 31 Dhjetor, 2018
Aktivet financiare				
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	531,149,253	473,434,942	531,149,253	473,434,942
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	8,642,586	4,854,274	8,642,586	4,854,274
Totali i aktiveve financiare	539,791,839	478,289,216	539,791,839	478,289,216
Detyrimet financiare				
Llogari të pagueshme dhe të tjera	117,284,200	88,088,786	117,284,200	88,088,786
Totali i detyrimeve financiare	117,368,603	88,088,786	117,368,603	88,088,786

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera mbarten me koston e tyre të amortizuar, duke i zbritur provizionet për zhvlerësim. Vlera e tyre e drejtë është e njëjtë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të afatit të tyre të shkurtër të maturimit.

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Vlera e drejtë e aktiveve monetare që përfshin mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, konsiderohet të jetë përafërsisht sa vlera e tyre përkatëse kontabël, për shkak të maturimit prej më pak se 3 muaj.

Llogari të pagueshme dhe të tjera

Vlera kontabël e furnitorëve dhe huave është përafërsisht sa vlera e tyre e drejtë për shkak të afatit të tyre të shkurtër të maturimit.

25. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Në Dhjetor 2019, një shpërthim i një lloji të ri të koronavirusit, COVID-19, u shfaq në Wuhan, Kinë. Brenda disa javësh, përkundër përpjekjeve për të përmirësuar virusin në Kinë që përfshinte mbyllje të gjerë të qyteteve dhe bizneseve, numri i të infektuarve u rrit ndjeshëm, dhe përtej kufijve të Kinës, përfshirë Shqipërinë.

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit njoftoi një situatë pandemike për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga shpërthimi i COVID 19. Përhapja e koronavirusit ende po evoluon dhe efektet e saj mbeten të panjohura. Për detaje të mëtejshme, ju lutemi referojuni Shënimit 4.2 "Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit në zbatimin e politikave të kontabilitetit".

Nuk ka ngjarje të tjera që do të kërkojnë rregullim ose zbulim në këto pasqyra financiare.